# AKT THEMELIMI
## I SHOQËRISË TREGËTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
## "HEALTHCARE" Sh. P. K.

Në Tiranë më datë 07.06.2022, ne mbeshteteje te Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret dhc shoqerite tregetare", formohet Shoqeria tregetare me pergjegjesi te kuifizuar e emertuar **"HEALTHCARE" sh.p.k** nga ortaku i vetem themelues:

**Z. Antonio Gualtieri** i biri i Francesco lindur në Davoli (CZ) më 28.11.1949 banues në Via S.Jon. II Tr. Pellaro, 153 Reggio Di Calabria (RC) Itali, shtetas italian, i pajisur me Karte Identiteti me numer CA96332FC.

### SELIA

**"HEALTHCARE" shpk** e ka seline e saj ne: Tiranë, Njesia Bashkiake Nr. 2, Rr. "George W. Bush", Ndertesa Nr. 5, Hyrja 5, kati 2, zyra 14. Shoqeria mund te hape filiale edhe ne rrethe te tjera brenda dhe jashte vendit.

### KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te Shoqerise tregetare eshte pa afat.

### OBJEKT1 I VEPRIMTARISE

*Shoqëria ka për objekt zhvillimin e këtyre aktiviteteve me objekt si vijon:*

- Ne fushen e sherbimeve mjekesore, industriale, dentare, farmaceutike, mjedisore dhe laboratoret universitare. Import dhe Eksport me shumice dhe pakice te pajisjeve mjekesore, reagente, materiale konsumi, pjese kembimi, preparateve farmaceutike, pajisje didaktike, pajisje analitike, tregtim dezinfektantesh dhe materiale mbrojtese per situate pandemike si COVID-19.
- Mirembajtje, riparim dhe trajnim teknik i te gjitha pajisjeve mjekesore, spitalore, didaktike dhe analitike, trajnime dhe konsulenca teknike per perdorim te pajisjeve mjekesore, didaktike dhe analitike.
- Tregtim me shumice i barnave per njerez. Shitja blerja, import dhe eksporti i artikujve farmaceutik, perberes aktiv farmaceutik, ushqimor - dietike, bimore, atyre homeopatike, i suplementave ushqimore, produkteve galenike per farmaci, kozmetike, estetik; paketimi dhe tregtimi me pakice dhe shumice i produkteve te percaktuara me siper, si dhe nepermjet nenkontraktimit.
- Fushata per ndergjegjesimin e publikut, trajtimi i mjeteve te transports per kujdesin shendetesor etj.
- Qender diagnostike mjekesore, qender kurative mjekesore. Studime dhe aplikime ne fushen e mjekesise.

- Paisje Mobilimi, Paisje IT, Furnizim dhe instalim te pajisjeve Software te cilesise se larte, PC, Servera, Printera, Fotokopje, Asistence teknike, riparime, instalime dhe konfigurime te sistemeve te perpunimit te te dhenave, instalim i rrjeteve kompjuterike, telekomunikacionit dhe mirembajtje e tyre.

*Ky aktivitet do të zhvillohet në fushën internacionale dhe në atë nacionale.*

Si objekt të veprimtarisë së saj shoqëria do të ketë edhe kryerjen e çdo operacioni ekonomik dhe juridik të lejuar nga legjislacioni shqiptar, që përputhet me objektin e veprimtarisë së saj dhe që kanë rëndësi për të ardhmen e shoqërisë.

## KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themeltar fillestar i Shoqerise eshte 100.000 leke, kontribut i Ortakut te vetem themelues eshte.

1- **Antonio Gualtieri,** 100% te kapitalit te shoqerise

## ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese te Shoqerise jane Asambleja e Ortakeve dhe Administratori te jete z. **Antonio Gualtieri**.

## NDARJA E FITIMEVE

Fitimet neto te Shoqerise qe rezultojne nga bilanci, pasi te zbriten shumat qe u perkasin detyrimeve ligjore, fondit rezerve dhe te tjera te percaktuara me ligj ose ne Statut, me vendim te Asamblese se Ortakeve ndahen perpjestimisht sipas kontributit perkates te Ortakeve.

## MOSMARREVESHJET

Mosmarreveshjet eventuale qe mund te lindin midis Ortakeve gjate zbatimit te ketij Akti Themelimi, ose midis Shoqerise dhe Ortakeve gjate aktivitetit te Shoqerise, duhet te zgjidhen me ane te bisedimeve. Ne rast te kundert palet i drejtohen Gjykates kompetente.

## TE TJERA

Dispozita me te hollesishme per funksionimin e Shoqerise, pershkruhen ne Statutin e saj qe eshte pjese perberese e ketij Akti Themelimi.

Ky Akt Themelimi eshte hartuar ne pese kopje te barazvlereshme dhe pasi u lexua u firmos rregullisht nga:

O R T A K U I V E T E M I S H O Q E R I S E

**"HEALTHCARE"** *sh.p.k*

**Z. Antonio Gualtieri**

ANTONIO GUALTIERI